



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2268/Prot.

Tiranë, më 12 .06.2026

VENDIM

Nr. 94, datë 10.06.2026

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT DENIS HYKA NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM Durrës, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 10.06.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për transferimin e prokurorit Denis Hyka në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës
së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet procedurës së lëvizjes
paralele”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2268 prot., datë 02.06.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoji Relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,



KOPJE WEB



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, *“Për shpalljen e 23 (njëzet e tre) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”*, Këshilli ka shpallur 23 (njëzet e tre) vendeve vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër dhe Tiranë. Një ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant nr. 5, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
3. Në datë 20.02.2025 në faqen zyrtare të internetit të Këshillit janë njoftuar të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afatin deri kur pranohen aplikimet, etj. Pas përfundimit të afatit të aplikimit në datë 06.03.2025, me Vendimin nr. 55, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve që kanë kandiduar për transferimin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ndër të cilët edhe kandidatët për vendin vakant si më sipër.
4. Me Vendimin nr. 56, datë 27.03.2025, *“Për caktimin me short të relatorit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli caktoi nëpërmjet procedurës së hedhjes së shortit relatorët për secilin pozicion të shpallur. Për pozicionin vakant nr. 5, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës u zgjodh si Relator z. Sokol Stojani.
5. Në cilësinë e Relatorit dhe në zbatim të neneve 11 pika 1 dhe 18, pika 1, të Vendimit nr. 261, datë 17.11.2020, *“Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, e ndryshuar (në vijim, Rregullorja), Relatori ka njoftuar kandidatët për këtë pozicion në rrugë elektronike (me e-mail), në datë 31.03.2025, për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar të Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.

Meqenëse pas kalimit të këtij afati nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e Relatorit ka filluar puna për verifikimin e plotësimit të kriterëve të vlerësimit nga ana e kandidatëve, bazuar në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim, Ligji për Statusin), si dhe nenet 8, 15 dhe 21 të Rregullores.



KOPJE WEB



6. Me Vendimin nr. 91, datë 14.05.2025, “Për verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për vendet vakante në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Këshilli miratoi listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar në këtë procedurë administrative dhe ndalimin e disa prej kandidatëve për vijimin e saj.

7. Për pozicionin vakant nr. 5, në zyrën e Prokurorisë Durrës kanë aplikuar prokurorët, sipas rendit alfabetik, si më poshtë vijon:

1. Anjeza Topçi – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Korçë (preferencë e dytë);

2. Brisida Leka - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Kukës (preferencë e dytë);

3. Denis Hyka – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (preferencë e tretë);

4. Denisa Plaku – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Gjirokastrë (preferencë e tretë);

5. Enea Babameto – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Korçë (preferencë e dytë);

6. Entela Hasmujaj – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Shkodër (preferencë e dytë);

7. Ervis Alliaj - prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (preferencë e dytë);

8. Gazmend Frëngu – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Gjirokastrë (preferencë e tretë);

9. Gëzim Spahiu – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Shkodër (preferencë e parë);

10. Griselda Haxhiaj – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Kukës (preferencë e tretë);

11. Iva Harka – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Lezhë (preferencë e dytë);

12. Jonida Allushi – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (Preferencë e parë);

13. Leonard Suçi – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Fier (preferencë e dytë);

14. Ndriçim Halilaj – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Shkodër (preferencë e tretë);

15. Olsi Vasiu – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Vlorë (preferencë e dytë);

16. Sonila Qerolla – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Dibër (preferencë e dytë);

17. Valbona Maja – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Sarandë (preferencë e tretë);

18. Vasjana Postol – prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Sh. I të Juridik. të Përgj. Korçë (preferencë e parë).



KOPJE WEB



8. Me Vendimin nr. 91, datë 14.05.2025, *“Për verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për vendet vakante në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm shpallur me vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, Këshilli miratoi listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar në këtë procedurë administrative si dhe ka ndaluar vijimin e procedurës administrative të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për prokurorët Anjeza Topçi, Brisida Leka, Enea Babameto dhe Sonila Qerolla.

9. Në këto kushte, vijuan garën për procedurën administrative të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant nr. 5, në zyrën e Prokurorisë Durrës, sipas rendit alfabetik, prokurorët:

1. Denis Hyka;
2. Denisa Plaku;
3. Entela Hasmujaj;
4. Ervis Alliaj;
5. Gazmend Frëngu;
6. Gëzim Spahiu;
7. Griselda Haxhiaj;
8. Iva Harka;
9. Jonida Allushi;
10. Leonard Suçi;
11. Ndriçim Halilaj;
12. Olsi Vasiu;
13. Valbona Maja;
14. Vasjana Postol.

10. Prokurorja Vasjana Postol, me Vendimin nr. 15, datë 15.01.2026, *“Për transferimin e prokurorit Vasjana Postol në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, të Këshillit është transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në zyrën e Prokurorisë Elbasan.

11. Prokurorja Jonida Allushi, me Vendimin nr. 16, datë 15.01.2026 *“Për transferimin e prokurorit Jonida Allushi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, të Këshillit është transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në zyrën e Prokurorisë Elbasan.

12. Ndërsa, kandidatët që kanë paraqitur dorëheqjen nga kandidimi janë si më poshtë vijon:

1. Entela Hasmujaj, me kërkesë nr.618/2exp25 prot., datë 07.05.2026;
2. Ervis Alliaj, me kërkesë nr. 1909/1 prot., datë 05.05.2026;
3. Leonard Suçi, me kërkesë nr. 1955/2 prot., datë 08.05.2026;
4. Ndriçim Halilaj, me kërkesë nr. 1959/2 prot., datë 21.05.2026;
5. Griselda Haxhiaj, me kërkesë nr. 1993/3 prot., datë 21.05.2026;
6. Denisa Plaku, me kërkesë nr. 1991 prot., datë 07.05.2026;
7. Gëzim Spahiu, me kërkesë nr. 1456 prot., datë 08.04.2026;
8. Olsi Vasiu, me kërkesë nr. 1934/1 prot., datë 11.05.2026;



KOPJE WEB



9. Iva Harka, me kërkesë nr. 2012 prot., datë 08.05.2026;
10. Valbona Maja, me kërkesë nr. 2032/1 prot., datë 21.05.2026;

13. Ndërkohë, me Vendimin nr. 88, datë 22.05.2026, *“Për transferimin e prokurorit Gazmend Frëngu në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, Këshilli ka miratuar transferimin e prokurorit Gazmend Frëngu në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
14. Në këto kushte, prokurori Denis Hyka mbetet kandidat i vetëm në garë dhe renditet i pari duke mos kaluar në vlerësimin krahasues të treguesve, të kriterëve dhe përparësive të tjera sipas të Ligjit për Statusin dhe Rregullores. Për rrjedhojë, mund të vijohet me caktimin në detyrë të prokurorit në këtë pozicion.
15. Kandidati Denis Hyka, me Vendimin nr. 200, datë 27.07.2022, *“Për caktimin në detyrën e prokurorit”*, të Këshillit është caktuar në detyrën e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Më pas, me Vendimin nr. 82, datë 24.04.2023, *“Për transferimin e përhershëm pa pëlqim të prokurorëve nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të cilat shkrihen për efekt ristrukturimi”* të Këshillit, ai është transferuar në zyrën e Prokurorisë Fier, ku ushtron detyrën aktualisht.
- Nga dosja personale e tij rezulton se, deri në datë 14.02.2025, kandidati ka rreth 2 vite e 7 muaj vjetërsi pune si magjistrat, të gjitha përvojë profesionale specifike në atë shkallë për të cilën kandidon.
16. Në këto kushte, bazuar në Kreun III dhe IV, të Rregullores, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit miratimin e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të z. Denis Hyka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në pozicionin vakant nr. 5, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit.
17. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimit të detyrës në mënyrë graduale, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës iu referua nenit 104, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:
- “1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.*
2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.
3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.
4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:
a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;



KOPJE WEB

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij;
ose

c) për gfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

18. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse do të krijohen në një moment të dytë, konkretisht në datë 22.06.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 261, datë 17.11.2020, Rregullore “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit Denis Hyka në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës duke filluar nga data 22.06.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Denis Hyka, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.06.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla